

Projekt - Vendim

Nr. 64 datë 18.06.2025

“Për miratimin e vijimësisë së marrëdhënies juridike të qiradhënies së pasurisë nr. 90/6 zk. 1762 e llojit “tokë bujqësore” me sipërfaqje 45 515 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin Gjorgoz Njësia Administrative Cakran, Bashkia Fier, për të cilën është lidhur kontrata e qirasë nr. 814 rep. nr. 280 kol. dt. 13.06.2023 ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjektit qiramarrës Ramadan Mehmetaj”.

Në bazë të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 8312 dt. 26.03.1998 “Për tokat bujqësore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo - territorial”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456 dt. 22.06.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësive Administrative Cakran Bashkia Fier Qarku Fier”, Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”, **Kryetari i Bashkisë;**

**PROPOZON**

1. Të miratojë vijimësinë e marrëdhënies juridike të qiradhënies së pasurisë nr. 90/6 zk. 1762 e llojit “tokë bujqësore”, me sipërfaqje 45 515 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin Gjorgoz Njësia Administrative Cakran, Bashkia Fier, në pronësi të Bashkisë Fier, për të cilën është lidhur kontrata e qirasë nr. 814 rep. nr. 280 kol. dt. 13.06.2023 ndërmjet Bashkisë Fier dhe subjektit qiramarrës Ramadan Mehmetaj.
2. Ky proces kryhet bazuar në ligjin 8312 dt. 26.03.1998 “Për tokat bujqësore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.
3. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave të mëtejshme administrativo - ligjore.

Drejtorja e Topografisë dhe Këshillimit bujqësor  
Drejtori: F. Elezi

Drejtorja e Menaxhimit të Pronave  
Drejtori: A. Behari

Drejtorja Juridike  
Drejtoresha: E. Kapllanaj

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**Martin DODI**



**KRYETARI**  
**Armando SUBASHI**